TERMAT DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR FURNIZIMIN E PRODUKTEVE DHE SHERBIMEVE TE HILTI ALBANIA SH.P.K.

në fuqi nga data 15.5.2023

1. Dispozita të përgjithshme

1.1 Termat dhe Kushtet e përgjithshme (në vijim referuar si "**Termat dhe Kushtet**") janë pjesë përbërëse e të gjitha shitjeve të produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga Hilti Albania sh.p.k. (në vijim referuar si "Hilti") personave juridik. Këto Terma dhe Kushte do të konsiderohen si pjesë përbërëse e të gjitha kontratave për furnizimin e produkteve dhe shërbimeve, edhe në rastet kur porositë janë marrë me telefon, personalisht, me faks, me e-mail ose e-commerce (nëse zbatohet).

1.2 Përveçse kur është rënë dakord ndryshe, bazuar në natyrën e shërbimeve të ofruara, dispozitat e këtyre Termave dhe Kushteve do të zbatohen mbi të gjitha dërgesat e produkteve dhe shërbimeve.

2. Çmimi dhe oferta

2.1 Produktet Hilti ofrohen nga ekspertët e shitjeve dhe teknik të Hiltit. Ofertat janë në Lekë dhe janë të vlefshme për një afat prej 4 javë nga data e nxjerrjes së tyre, përveçse kur është rënë dakord për një kusht tjetër në ofertën përkatëse.

2.2 Në kontratat kuadër për furnizimin e produkteve dhe/ose shërbimeve, në të cilat çmimet e produkteve ose shërbimeve që Hilti mund të furnizojë në bazë të këtyre kontratave janë të përcaktuara, Hilti rezervon të drejtën të ndryshojë çmimet e produkteve ose shërbimeve në mënyrë të njëanshme dhe sipas diskrecionit të vet, të ndryshojë kushtet e zbatimit të porosive, kushtet e dërgimit dhe/ose pagesës, për shkak të ndryshimeve thelbësore në kushtet e tregut, duke përfshirë, por jo kufizuar në ndryshimet e çmimeve të lëndëve të para dhe të tjera kushte që kanë lidhje me të. Në një rast të tillë, Hilti duhet të njoftojë me shkrim klientin për ndryshimin përkatës.

2.3 Në kontratat kuadër për furnizimin e produkteve dhe/ose shërbimeve,në të cilat është rënë dakord për shitje apo për një tjetër zbritje, Hilti ka të drejtë në çdo kohë, në mënyrë të njëanshme dhe pa njoftuar klientin të ndryshojë çmimin e produkteve dhe/ose shërbimeve për të cilat është caktuar zbritja përkatëse.

3. **Porositë për blerjen e produkteve dhe shërbimeve**

3.1 Produktet Hilti porositen në qendrat e tregtimit Hilti me telefon, e-mail, faks, nëpërmjet website ose përmes mjeteve të tjera të komunikimit të përcaktuara në kuadër të marrëdhënieve tregtare midis klientit dhe Hiltit.

3.2 Kur produktet e porositura nuk janë dorëzuar në qendrat e tregtimit Hilti në kohën e kryerjes së porosisë si edhe kur porosia është kryer me telefon, e-mail, faks, website apo me një mënyrë tjetër të komunikimit në distancë, Hilti e harton porosinë e klientit në formën e një kërkese të shkruar për dorëzim, e cila i ofrohet/dërgohet klientit në mënyrën e duhur.

3.3 Kërkesa e dorëzimit e nënshkruar nga Hilti dhe nga një përfaqësues i autorizuar i klientit do të përbëjë marrëveshjen për dorëzimin e mallrave të porositura. Para dërgimit të produkteve të porositura, Hilti mund të kërkojë që kërkesa e dorëzimit të nënshkruhet nga një përfaqësues ligjor ose nga një person tjetër që ka të drejtë të porosisë produktet në emër e për llogari të klientit.

3.4 Produktet, të cilat nuk gjenden normalisht në magazinë, porositen pas pagesës së një paradhënie sa 100% e çmimit dhe në bazë të kushteve të dorëzimit të paracaktuara, përveçse kur është rënë dakord ndryshe me shkrim midis palëve.

4. Dorëzimi i produkteve

4.1 Përveçse kur është rënë dakord ndryshe midis klientit dhe Hiltit, produktet e porositura do të dorëzohen në të njëjtën qendër tregtimi Hilti ku ato janë porositur apo në atë që është përcaktuar në kërkesën e dorëzimit. Në rast të dorëzimit të produkteve që nuk mbahen në magazinë, Hilti duhet të njoftojë klientin për disponueshmërinë e produkteve në qendrat përkatëse të tregtimit.

4.2 Me kërkesë të klientit, produktet e porositura mund të dorëzohen në një vend të caktuar. Dorëzimi kryhet nga Hilti ose nga një korrier kundrejt pagesës. Nëse nuk është rënë dakord ndryshe me shkrim midis palëve, në rast të dorëzimit të produkteve nga një korrier, rreziku i shkatërrimit aksidental, dëmtimit ose humbjes së produkteve i transferohet blerësit në momentin e dorëzimit të produkteve nga korireri.

4.3 Të gjitha kushtet e dorëzimit të përcaktuara në kërkesën e dorëzimit ose në këto Terma dhe Kushte janë thjesht indikative dhe jo detyruese dhe Hilti nuk do të jetë përgjegjës në rast të dështimit për të kryer dorëzimin përkatës pikërisht në ditën ose brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e dorëzimit ose në Termat dhe Kushtet.

4.4 Pas dorëzimit të mallrave në vendodhjen e përcaktuar nga klienti, ky i fundit është i detyruar të marrë masat për pranimin e dorëzimit nga ana e personit të autorizuar për të bërë këtë, përndryshe, çdo punonjës i klientit ose çdo person që është i pranishëm në vendin e dorëzimit, do të konsiderohet se është i autorizuar nga klienti për të pranuar dorëzimin e produkteve.

4.5 Për çdo dorëzim të produkteve, Hilti do të lëshojë një faturë që përmban një përshkrim të të gjitha produkteve që dorëzohen. Kjo faturë do të nënshkruhet në emër e për llogari të klientit nga personi i përcaktuar në pikën 4.4. Me nënshkrimin e faturës si më sipër, do të konsiderohet se klienti ka pranuar produktet, nuk ka ankesa dhe nuk ka identifikuar ndonjë defekt të dukshëm në lidhje me to.

5. Dorëzimi i shërbimeve

5.1 Hilti i ofron shërbimet në qendrat e veta të tregtimit, në vendodhje të tjera të tij si dhe në vendodhjet e përcaktuara nga klienti. Nëse shërbimet ofrohen në një vend të caktuar nga klientit, klienti duhet të sigurojë:

a) akses të sigurt të punonjësve të Hiltit ose të nënkontraktorëve,
b) secilin nga pëlqimet dhe lejet (nëse janë të nevojshme) për kryerjen e shërbimit përkatës,
c) secilin nga kushtete nevojshme për ofrimin e shërbimit,të tilla si ndriçimi, energjia elektrike, etj,
d) kushte pune të sigurta dhe të shëndetshme në vendin ku ofrohen shërbimet,
e) që punonjësit e Hiltit apo nënkontraktorët janë udhëzuar në mënyrën e duhur mbi secilin nga kushtet specifike të punës, aksesit dhe masave të sigurisë në strukturën ku ofrohen shërbimet.

5.2 Kur klienti nuk ka siguruar kushtet e nevojshme të punës në përputhje me pikën 5.1, Hilti mund të refuzojë për të filluar kryerjen e shërbimeve derisa kushtet e duhura të punës të sigurohen nga klienti.

5.3 Në hipotezën sipas pikës 5.2 më sipër, afati i fundit për ofrimin e shërbimeve do të zgjatet në përputhje me vonesën në ofrimin e kushteve të duhura të punës nga ana e klientit. Në raste të tilla, Hilti gjithashtu ka të drejtën e një pagese shtesë për kohën e shpenzuar dhe/ose të kompensimit për shpenzimet e bëra për shkak të vonesës së klientit.

5.4 Në të gjitha rastet kur shërbimet ofrohen në vendodhjen e klientit, klienti do të jetë përgjegjës për të dëmtimin ose vdekjen e punonjësit të Hiltit, për çdo dëm monetar/jo monetar të shkaktuar punonjësve të Hiltit ose nënkontraktorëve, gjatë qëndrimit të tyre në vendodhjen e klientit, në të cilin ofrohet shërbimi, përveçse kur dëmi përkatës ka ndodhur për shkak të neglizhencës së madhe të Hiltit ose të nënkontraktorëve të tij.

6. Faturimi dhe pagesa

6.1 Faturat për produktet e dorëzuara duhet t'i lëshohen dhe jepen klientit së bashku me furnizimin dhe dorëzimin e produkteve. Faturat do të konsiderohen të marra nga klienti në datën e përcaktuar në vërtetimin e pagesës nga ana e personit sipas pikës 4.4.më sipër. Nëse kjo datë nuk është e përcaktuar dhe fatura përkatëse është nënshkruar nga personi sipas pikës 4.4., fatura do të konsiderohet e marrë nga klienti në datën e lëshimit të saj.

6.2 Pagesa do të bëhet *cash*, përmes transfertës bankare, transfertave postare të parasë dhe me kartë krediti. Hilti mund të përcaktojë kushte të ndryshme të pagesës sipas gjykimit të vet në varësi të historisë së marrëdhënieve të saj me klientin.

6.3 Përveçse kur është rënë dakord ndryshe, çmimi i produkteve, të dërguara në qendrat e tregtimit Hilti, do të paguhet pas dorëzimit së produkteve. Çmimi i produkteve të dorëzuara te klienti, dhe, nëse është rënë dakord, edhe çmimi i produkteve të dorëzuara në qendrat e tregtimit Hilti, do të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga data e lëshimit të faturës përkatëse, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe me shkrim ndërmjet palëve.

6.4 Në qoftë se palët nuk kanë rënë dakord shprehimisht mbi afatin përfundimtar për pagesën e faturës, klienti do të paguajë shumën e përcaktuar në faturë në afatin më të shkurtër midis afatit të përcaktuar në një kërkesë dorëzimi, afatit sipas pikës 6.3 dhe afatit të pagesës të përcaktuar në faturën e dorëzimit.

6.5 Në qoftë se çmimi i produkteve të dorëzuara nuk është paguar në përputhje me kushtet e pagesës, Hilti ruan pronësinë mbi produktet e dorëzuara derisa çmimi të paguhet plotësisht.

6.6 Në rast të pagesës së vonuar, Hilti do të zbatojë interesin ligjor për shkak vonese në shumën e caktuar me ligj.

7. Kushtet e garancisë dhe shërbimi i riparimit

7.1 Produktet Hilti mund të përdoren vetëm për qëllimet e specifikuara në dokumentet shoqëruese të produkteve. Hilti nuk merr përsipër ose nuk garanton që produktet Hilti mund të përdoren për një qëllim që nuk është i specifikuar në dokumentacionin teknik të produktit përkatës.

7.2 Hilti ofron një garanci të përgjithshme prej 12 muajsh nga data e dorëzimit për difektet materiale dhe difektet e prodhimit.

Garancia do të jetë e vlefshme vetëm nëse ekzistojnë të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Produkti është përdorur në mënyrën e duhur sipas udhëzimeve operative të parashikuara
- Produkti është kthyer i paprekur, i plotë me të gjitha pjesët përbërëse dhe nuk është manipuluar
- Nuk janë bërë ndërhyrje teknike, riparime dhe/ose modifikime mbi produktin nga klienti ose nga palë të treta
- Defekti nuk ka ndodhur për shkak të rënies, manipulimit, keqpërdorimit, sjelljes së papërshtatshme dhe/ose neglizhencës së klientit, vandalizmit, goditjeve të dhunshme, fenomeneve atmosferike dhe/ose fatkeqësive natyrore.

7.3 Garancia e përgjithshme e përshkruar në pikën 7.2 më sipër jepet gjithmonë, përveç rastit kur Hilti ofron për klientët e saj një periudhë më të gjatë që përcaktohet në faqen e internetit dhe / ose në katalogun e përgjithshëm.

7.4 Për shkak të natyrës së produkteve të caktuara, të tilla si zinxhirat, sistemet e instalimit, produktet kimike, etj, Hilti vetëm mund të sigurojë që këto plotësojnë kërkesat dhe specifikimet e dokumentacionin teknik shoqërues. Në lidhje me këto produkte, Hilti do të mbajë vetëm përgjegjësinë e shitësit për defektet e produkteve të shitura sipas Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", neni 716.

7.5 Afatet për të ngritur pretendimet për garancinë ose post-garancinë apo pretendime të tjera, do të fillojë nga data e marrjes së produktit përkatës nga ana e klientit. Afati i fundit për pretendimet e garancisë për makinat e riparuara do të fillojë nga momenti kur klienti është njoftuar për përfundimin e riparimit sipas pikës 12.1. Kur një pretendim për garanci/post-garanci është bërë me postë, e-mail, fax ose në mënyra të tjera pa paraqitur mjetin me defekt, klienti duhet ta dorëzojë mjetin brenda 8 ditësh nga dita e dorëzimit (dërgimit) të pretendimit.

7.6 Në çdo rast kur është ngritur një pretendim lidhur me garancinë apo ndonjë pretendim tjetër, Hilti mund të konsiderojë, në diskrecionin e saj, nëse do të riparojë produktin, ta zëvendësojë atë, ose t'i rimbursojë klientit çmimin e blerjes. Nëse produkti nuk prodhohet më, ose është tërhequr nga tregu, Hilti mund ta zëvendësojë atë me një produkt të ngjashëm që ka të njëjtin qëllim dhe karakteristika teknike dhe specifikime të njëjta ose më të mira.

8. Përgjegjësia dhe kufizimi i përgjegjësisë

8.1 Klienti ka detyrimin të mos i përdorë mjetet Hilti për qëllime të paligjshme ose në mënyrë të paligjshme, pra klienti do ta zhdëmtojë Hiltin nga çdo përdorim i paligjshëm nga ana e punonjësve të tij, kontraktorëve dhe/ose agjentëve.

8.2 Jashtë garancisë dhe përgjegjësisë për pretendimet e ngritura sipas nenit 7 më sipër, Hilti nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi për çdo dëm të shkaktuar nga faji, mangësitë dhe/ose mospajtueshmërisë me specifikimet teknike të produkteve të dorëzuara apo për moskryerjen e shërbimeve.

8.3 Hilti kurrë nuk do të jetë përgjegjës për humbjen indirekte ose konsekuenciale (p.sh. kostot e riparimit, shpenzimet për humbjen e fitimit ose ndërprerjes së biznesit) dhe as nuk do të jetë përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar, i cili nuk mund të parashikohej gjatë nënshkrimit të kontratës individuale për dorëzimin e produkteve dhe/ose shërbimeve si dhe as për çfarëdo dëm të ndodhur si rezultat i forcës madhore, duke përfshirë luftërat, trazirat, grevat, etj dhe më në përgjithësi, për çdo rast të një natyre të jashtëzakonshme që shkon përtej kontrollit.

8.4 Në çdo rast kur Hilti konsiderohet përgjegjës në bazë të një kontrate individuale, kontratë kuadër ose në bazë të ligjit, përgjegjësia e Hiltit do të kufizohet deri në çmimin e produkteve ose shërbimeve përkatëse.

8.5 Klienti ka detyrimin t'i sigurojë Hiltit, sipas kërkesës, të gjitha informacionet dhe dokumentet e kërkuara për të respektuar rregulloret e kontrollit të eksportit. Nëse klienti i ofron produktet Hilti një pale të tretë (përfshirë filialet e klientit), klienti merr përsipër të respektojë rregulloret e kontrollit të eksportit. Hilti ka të drejtë të refuzojë përmbushjen e kontratës në rast të shkeljes së kësaj dispozite.

8.6 Hilti ka të drejtë të refuzojë pranimin e porosive nëse një pranim i tillë behet tepër i veshtire ose ndalohet nga rregulloret e kontrollit të eksportit dhe/ose rregulloret doganore.

9. Forca madhore

9.1 Hilti nuk do të jetë përgjegjës për shkeljen e detyrimeve të tij për shkak të ngjarjeve të forcës madhore. Ngjarje që përbëjnë forcë madhore do të jenë zjarret, përmbytjet, katastrofat e tjera natyrore, luftërat, revolucionet, aktet e terrorizmit, protestat, grevat dhe veprime të tjera industriale dhe situata/aksidente të tilla si mungesa e energjisë elektrike, energjisë, karbur anteve, transportit dhe të tjera, të cilat mund të ndikojnë negativisht në zinxhirin e furnizimit të Hiltit, si dhe ngjarjet që janë jashtë kontrollit të Hiltit.

9.2 Ekzistenca e një force madhore nuk e liron asnjërën prej palëve nga detyrimet e veta për pagesë.

10. Zgjidhja e kontratës së dorëzimit. Sigurimi i zbatimit të kontratës

10.1 Hilti mund të zgjidhë në mënyrë të njëanshme çdo kontratë për furnizimin e produkteve ose shërbimeve para se të kryejë dorëzimin përkatës, në qoftë se është hapur një pro cedurë falimentimi ndaj klientit ose janë marrë masa sigurimi paraprak, si dhe në qoftë se kreditori i një klienti fillon procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm mbi një pronë të lënë peng në përputhje me Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" ose mbi të cilën është vënë barrë siguruese në përputhje me Ligjin nr. 8537, datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese".

10.2 Në rastet e përcaktuara në pikën 10.1 më lart, si dhe në çdo rast tjetër kur Hilti, në bazë të konsideratave të tij, ka identifikuar ndonjë rrezik që dëmton gjendjen e mirë të aftësisë paguese të klientit, Hilti mund t'i kërkojë klientit, pa e zgjidhur kontratën përkatëse të dorëzimit, të kryejë një paradhënie të pjesshme ose të plotë për produktet apo shërbimet që do të ofrohen. Në këtë rast, kushtet e dorëzimit konsiderohen të pezulluara deri kur paradhënia përkatëse e pjesshme ose e plotë të jetë kryer në mënyrë të rregullt nga klienti.

11. Pronësia intelektuale

11.1 Të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale që lidhen me produktet e shitura në bazë të këtyre kushteve të përgjithshme i përkasin ekskluzivisht Hilti Albania sh.p.k. dhe Grupit Hilti.

Përveçse kur palët bien dakord ndryshe, blerja e produkteve Hilti nuk përbën leje të dhënë nga Hilti për klientët për të përdorur ose kopjuar të drejtat e pronësisë intelektuale të Hiltit mbi këto produkte, pavarësisht nëse këto të drejta i referohen teknologjisë së përdorur, reklamimit të produkteve ose të markave tregtare në bazë të të cilave janë shitur produktet.

12. Dispozitat e veçanta për riparimin e pajisjeve

12.1 Në rastet kur Hilti jep garanci ose post-garanci për riparimin e pajisjeve, klienti do ta marrë pajisjen e riparuar brenda 14 ditëve pas marrjes së njoftimit për përfundimin e riparimit. Pas skadimit të afatit të mësipërm, Hilti do të fillojë të zbatojë një tarifë ditore për ruajtjen (magazinimin) e pajisjes.

12.2 Nëse klienti nuk tërheq pajisjen e riparuar brenda 2 (dy) muajve nga njoftimi sipas pikës 12.1, Hilti do të konsiderohet i autorizuar nga klienti për të shitur pajisjen për llogari të klientit me një çmim dhe te një person i përcaktuar nga vetë Hilti. Çmimi i blerjes duhet të shlyejë shpenzimet e Hiltit për riparimin dhe magazinimin e pajisjes dhe shuma e mbetur (nëse ka) do të mbahet nga Hilti dhe do të vihet në dispozicion në bazë të kërkesës së klientit.

13. Korrespondenca

13.1 E gjithë korrespondenca ndërmjet palëve në lidhje me nënshkrimin, zbatimin, zgjidhjen dhe anulimin e kontratës për furnizimin e produkteve dhe shërbimeve do të bëhet me shkrim dhe do t'i drejtohet personave të kontaktit dhe adresave të korrespondencës të palëve, të përcaktuara në marrëveshjen individuale ose kuadër të furnizimit.

13.2 Nëse korrespondenca kryhet me anë të postës elektronike (e-mail), forma me shkrim do të konsiderohet e realizuar, nëse plotësohen kërkesat e mëposhtme:

a) deklaratat e klientit origjinohen nga e-maili i përcaktuar si e-mail i korrespondencës i klientit në marrëveshjen individuale ose kuadër të furnizimit dhe i adresohen të paktën (mundet, gjithashtu, të specifikohen adresa të shumta) adresës vijuese të e-mailit të Hilti: Admir.Ngjela@hilti.com

b) deklaratat e Hiltii adresohen e-mailit të përcaktuar si e-mail i korrespondencës i klientit në marrëveshjen individuale ose kuadër të furnizimit; të gjitha mesazhet e-mail, në dalje nga një adresë e-mail me emër domain-i@ *hilti.com* konsiderohen se dërgohen në emër e për llogari të Hilti.

13.3 Mesazhet, e dërguara nëpërmjet postës elektronike, do të konsiderohen të marra:

a) në ditën e dërgimit të tyre, në qoftë se janë dërguar para orës 5:00 p.m. gjatë ditëve të punës, ose

b) në ditën e parë të punës pas dërgimit të tyre, në qoftë se janë dërguar në ditë pushimi ose pas orës 5:00 p.m. në një ditë pune.

13.4 Komunikimi telefonik apo çdo korrespondencë tjetër orale ndërmjet palëve duhet të konfirmohet (riformuluar) me shkrim në përputhje me pikat e mësipërme. Si datë e telefonatës apo e korrespondencës tjetër orale do të konsiderohet data e konfirmimit të saj (riformulimit) me shkrim.

14. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve. Ligji i aplikueshëm.

14.1 Të gjitha mosmarrëveshjet ndërmjet Hilti dhe një klienti në lidhje me nënshkrimin, zbatimin, zgjidhjen ose anulimin e kontratës për furnizimin e produkteve dhe/ose shërbimeve do të zgjidhen nëpërmjet negociatave midis palëve nën frymën e mirëkuptimit të ndërsjellë. Nëse palët nuk arrijnë në një marrëveshje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë ekskluzivisht kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje.

14.2 Përveçsekur është rënë dakord ndryshe, kontratat për furnizimin e produkteve dhe/ose shërbimeve ndaj të cilave zbatohen këto Terma dhe Kushtedo t'i nënshtrohen legjislacionit shqiptar.

15. Autoriteti për të negociuar

15.1 Ekspertët e shitjeve dhe teknik të Hilti nuk janë të autorizuar të negociojnë asnjë prej kushteve të kontratave të furnizimit, të cilat bien ndesh me këto Terma dhe Kushte, ose të bëjnë deklarata dhe të lëshojnë dokumenta që japin garanci të ndryshme për produktet Hilti.

16. Konfliktet me kushtet e tjera

16.1 Nëse këto Terma dhe Kushte janë në konflikt me ndonjë dispozitë sipas termave dhe kushteve të përgjithshme të përdorura nga një klient për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve, këto Terma dhe Kushte do të mbizotërojnë ndaj të kushteve të përgjithshme të klientit për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve.

17. Ndryshimi i Termave dhe Kushteve

17.1 Këto Terma dhe Kushte mund të ndryshohen nga Hilti në çdo kohë pa qenë i detyruar të njoftojë paraprakisht klientët e tij për to.

17.2 Çdo dorëzim i produkteve dhe shërbimeve do të rregullohet nga kushtet e përgjithshme për furnizimin e produkteve dhe shërbimeve në fuqi në kohën e nënshkrimit të kontratës përkatëse individuale të furnizimit.